

SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERË SHA.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mhyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK, përvçese ku shprehet ndryshe)

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a, shoqëri aksionere me kapital të regjistruar prej 420.663.000 lekë, i ndarë në 420,663 aksione me vlerë nominale 1000 lekë/aksion, tërësisht i paguar, me seli tek ish "Tipografia Ushtarake" Tiranë, c përfaqësuar nga administrator i Shoqërisë Z. Besmir HYSA.

Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë gjatë vitit 2020 përbëhet nga Z.Rudolf Papa – Kryetar si dhe anëtarët Znj. Silvia Qesku, Znj. Majlinda Demko, Znj. Dajna Sorensen, Znj.Arjana Dyrnishi, Znj. Diana Dervishi

Numri mesatar i të punësuarve gjatë Vitiit 2020 eshte 87 punonjës. Gjatë vitit 2021 janë ndjekur procedurat e Bashkimit me përthithje te "Tipografisë Ushtarake " sha bazuar ne Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve Nr 9 date 8.02.2021 për Miratimin e Marrëveshjes së Bashkim me përthithje të Tipografisë Ushtarake sh.a nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë Sha" Tiranë si dhe bazuar në Raportin e Audituesit Ligjor Nr 423 prot d: 14.09.2020 " Për Bashkimin me Përthithjje të "Tipografisë Ushtarake" nga Shoqëria Shtypshkrorja e Letrave me Vlerë Sha" Tiranë.

Në raportin e audituesit Ligjor fq. 8 pasqyrohet bilanci i Bashkimit më datë 31.12.2019, në të cilin janë paraqitura të përthithura elementë të aktivit dhe pasivit të pasqyrave financiare.

Gjithashtu aucituesi ligjor ka pasqyruar dhe levizjet përsa i përket Kapitalit të Shoqërisë (fq 11) në zvogëlim të kapitalit nga 430,238,000 në 420,663,000 lekë (zvoglim i kapitalit nga bashkimi në vlerën 9,575,000 lekë).

2. BAZAT E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare te Kontabilitetit (referuar ketej e tutje si SKK) dhe bazuar në Ligjin nr 25/2019 date 10 maj 2019 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare " dhe në përputhje me politikat e grupit. Pasqyrat financiare janë përgatitur duke respektuar parimin e kostos historike dhe parimin e vijimësisë. Keto pasqyra financiare janë paraqitur ne Lek, e cila eshte edhe monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë.

Standarte, ligje, interpretime dhe amendime efektive ne periudhen aktuale

Politikat kontabël te adoptuara janë konsistente me politikat e viti; të mëparshëm me përashtim të SKK –ve te ndryshuara , të cilat janë adaptuar nga Shoqëria në datën 1 janar 2020.

Ligji i ri i kontabilitetit

Pas përpjekjeve të qeverisë shqiptare në trugën e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, Paramenti Shqiptar aprovoi më 10 Maj 2019 Ligjin nr. 25/2019 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare " (tani e tutje referuar si 'Ligji i ri për kontabilitetin 'ose 'Ligji i Ri'), i cili shfuqizon ligjin e mëparshëm ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004. Ligji i ri për kontabilitetin është

SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERE SIIA.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK, përvçese ku shprehet ndryshe)

pjesërisht në linjë me Direktivat respektive Europiane me qëllim për përshtatje të plote në vitin 2028. Ligji i ri është në fuqi më 1 Janar 2020. Aplikimi i Ligjit të ri për kontabilitetin nuk ka efekte materiale në pozicionin finansiar dhe performancën e Shoqerisë.

Permirsime të SKK 2 Paraqitja e Pasqyrave Financiare

Përmisimi i SKK 2 Paraqitja e Pasqyrave Financiare sqaron kërkesat e këtij standarti pa pasur ndryshime te tij në mënyre domethënëse. Ndryshimet sqarojnë:

- Informacion i nevojshëm për të identifikuar entitetin;
- Informacion shtesë për aktivet afatgjata materiale;
- Shumat e kompensuara duhet të paraqiten në vlerën e tyre brutto në shenime;
- Më tepër shënime rrëth te ardhurave;

Këto përmirsime janë efektive në periudhën aktuale. Aplikimi i këtyre ndryshimeve nuk ka efekt ne Pasqyrat Financiare të Shoqerisë.

Permirsime të SKK 2 Kombinimi i Bizneseve

Ndryshimet e SKK 9 Kombinimi i Bizneseve shtojnë disa kërkesa në përputhje me Direktivat e EU. Ndryshimet sqarojnë:

- Paraqitja e pjesëmarrjes në konsolidim , rastë kur shoqëritë nuk kanë detyrimin përgatijen e Pasqyrave Financiare të konsoliduara, përgatija e pasqyrave financiare të konsoliduara në një datë tjeter raportimi, shënimet e pasqyrave financiare duhet të jepin metodat e përdorura për kalkulimin e emrit të mirë në rjë kombinim biznesi si dhe ndonjë ndryshim domethënës krahasuar me pasqyrat financiare te vitit të kaluar;
- Pasqyrat financiare të shoqërise mëmë duhet te jepin informacionin mbi:
 - (a) në lidhje me njësitë ekonomike të përfshira në konsolidim emrat dhe selitë e regjistruara të këtyre njësive ekonomike, përqindjen e kapitalit të mbajtur në këto njësi ekonomike;
 - (b) emrat dhe selinë e regjistruar të njësive ekonomike ku njësitë e përfshira në konsolidim kanë interesa pjesëmarrëse;
 - (c) emrat dhe selinë e regjistruar të njësive ekonomike të konsoliduara në mënyrë proporcionale;
 - (d) në lidhje me edo entitet ku shoqëria mëmë ka interes;
- Shoqëria mëmë duhet të paraqesë disa shënimë në rastet kur shoqëria mëmë është e përashtuar nga detyrimi për të përgatitur pasqyra financiare të konsoliduara .

Këto përmirsime janë efektive më 1 Janar 2020 . Aplikimi i këtyre ndryshimeve nuk kanë çfakt ne pasqyrat financiare të Shoqerisë.

Standarte, ligje, interpretime dhe amendime që ende nuk kanë hyre në fuqi dhe nuk janë adoptuar

Gjatë vitit 2020 Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit During 2020 ka shpallur disa përmirsimë për standartet aktuale SKK të cilat nuk janë efektive në datën e pasqyrave

SHTYP SHKRONJA E LETRAVE ME VLERE SHA.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK, përvçese ku shprehet ndryshe)

financiare të Shoqërisë. Këto përmisime lidhen me SKK 3 Instrumentat Financiare , SKK 5 Aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale, SKK 11 Tatim Fitimi, SKK 13 asetat biologjike dhe marreveshjet koncessionare.Këto përmisime do të janë efektive më 01 Janar 2020. Aplikimi i këtyre ndryshimeve nuk do të ketë efekt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të ushtrojnë gjykimin, vlerësimin dhe supozimet që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati faktik mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të pasigurisë së vlerësimeve dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë kontabël të veprimeve të realizuara nga Shoqërise.

3. BAZAT E MATJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të *kostos historike* duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit të të drejtave të korstatuara.

4. MONEDHAT FUNKSIONALE

Këto pasqyra financiare individuale janë paraqitur në Lek, e cila është edhe moneda funksionale dhe raportuese e Shoqërisë.

5. PERDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të ushtrojnë gjykimin, vlerësimin dhe supozimet që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken. Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të pasigurisë së vlerësimeve dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë kontabël të veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERE SHA.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK, përvçese ku shprehet ndryshe)

6. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABEL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhc detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të aplikueshme nga Banka e Shqipërisë për këmbimin e LEK-ut me USD dhe Euro më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2019 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
US Dollar (USD)	108.64	107.82
Euro (EUR)	121.77	123.42

Instrumentat finanziarë

Instrumentat finanziarë jo-derivativë përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, llogari të arkëtueshme, llogari tregtarë të pagueshme dhe llogari të tjera të pagueshme.

Instrumentat finanziarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi i që lidhet me to (për instrumentat jo të mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes), përvç siç përshkruhet më poshtë. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat finanziarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument finansiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset monetare të aktivit finansiar ose kur Shoqëria transferon aktivin finansiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përsitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhc shitjet normale të aktivave financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

i. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë, mjetet monetare dhe



SHTYPSIHKRONJA E LETRAVE ME VLERE SIIA.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK, përvetësojnë shprehjet ndryshe)

ekuivalentët e tyre përfshijnë depozita të pakushtëzuara me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Rakordimi i totalit të mjeteve monetare në arkë dhe në bankë me mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre është paraqitur në shënimin 7.

ii. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme nijhen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigioni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna objektive se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitet financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij finansiar dhe vonesat në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme duhet të zhvlerësohen. Shuma e provigionit llogaritet si diferençë midis vlerës kontabël (neto) të aktivit dhe vlerës aktuale të flukscave të archshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

iii. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë në njohjen fillestare dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

iv. Vlera e drejtë

Nuk ka politika të rëndësishme kontabël dhe paraqitje të aplikuara nga Shoqëria që të kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet si ato financiare dhe ato jo financiare. Atje ku është e aplikueshme, informacion shtesë në lidhje me supozimet e bëra për përcaktimin e vlerës së drejtë është përfshirë në shënimet shpjeguese të aktivit apo detyrimit përkatës. Vlera e drejtë e vlerësuar e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, e kërkuesave për t'u arkëtar dhe e detyrimeve për t'u paguar është e ngjashme me vlerën e tyre kontabël për shkak të maturimit të tyre afatshikurtër.

v. Të tjera

Instrumenta të tjere jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Aktive afatgjata material

i. Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerra jashtë përdorimit e ndonjë zeri të aktiveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerra jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) dhe janë pasqyruar neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.



SHTYPSIKRONJA E LETRAVE ME VLERE SHA.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK, përvetësuar këtë shprehje ndryshe)

ii. Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të aktive afatgjata materiale është njojur në vlerën kontabël (neto) të pjesës rë qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve afatgjata materiale janë të njoitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me çira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

Kategoria e aktivit	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Ndertesa	Mbi Vleren e mbetur	5 %
Makineri e paisje mobilje	Mbi Vleren e mbetur	20 %
Paisje Informatike	Mbi Vleren e mbetur	25 %
Mjete transporti	Mbi Vleren e mbetur	20 %
Aktive jo material	Mbi koston historike	15 %

Zhvlerësimi

i. Aktivet financiare

Një aktiv finansiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive zhvlerësimi si rezultat i një osc më tëpër ngjarjeve që kanë ndodhur pas njoftes fillostarte të aktivit dhe që kanë patur një ndikim në flukset e ardhshme monetare të vlerësuara të aktivit finansiar dhe këto efekte janë të matshme në mënyrë të besueshme.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv finansiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferenca mes vlerës kontabël (neto) dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të parasë duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit.

Në veçanti aktivet finansiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera finansiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të irrezikut krediter. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njoftes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet finansiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.



SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERE SHA.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK, përvçese ku shprehet ndryshe)

ii. Aktivet jo financiare

Vlera kontabël (neto) e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë rishikohet në çdo datë raportimi për të përektuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e lartë ndërmjet vlerës së drejtë minus kostos së shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare të pritshtme skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktivit për të cilat parashikimet e flukseve të ardhshme monetare nuk janë rregulluar.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël (neto) e një aktivit tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Provigionet

Një provigion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria nuk ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që të kërkojë flukse dalëse monetare për shlyerjen e tij. Provigionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshtme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe përrreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në përputhje me SKK 8 Të ardhurat. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lichur me arkëtimin e pagesës dhe matjen e kostove përkatëse.

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur janë plotësuar të gjitha kushte e mëposhtme:

- Shoqëria ia ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e mallrave;
- Shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në manaxhimin e mallrave në atë masë që tregon se ende zoteron titullin e pronësisë; si dhe nuk ka kontroll efektiv mbi mallrat e shitura;
- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- Është e mundur që përfitimet ekonomike që lidhen me transaksionin do të merren nga njësia ekonomike; dhe
- Shpenzimet e bëra ose që do të bëhen në lidhje me transaksionin mund të maten me besueshmëri

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për illogaritë rrjedhëse në bankë dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen kur realizohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë interesat nga huamarrjet dhe humbjet nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve

SHITYPHKRONJA E LETRAVE ME VLERE SHA.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK, përvetësuar me fitimin e mbyllur)

financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes (nëse ka). Kostot e huamarjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatushme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës. Fitimi i tatushem ndryshon nga fitimi neto që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sepse ai përjashton zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatushme apo të zbritshëm në vite të tjera dhe gjithashtu përjashton zëra që nuk janë kurrë të tatushëm apo të zbritshëm. Detyrimi i shoqërisë për tatim fitimin e vitit llogaritet duke përdorur normat e tatimit të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar për kontabilitetin në Shqipëri. Norma aktuale mbi fitimin është 15 %. Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Detyrimi tatimor i shtyrë njihet për tatimet e zbritshme ose të pagueshme për periudhat e ardhshme si rezultat i transaksioneve ose ngjarjeve të kaluara. Këto tatime lindin nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar dhe njohjes së këtyre activeve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore, si dhe nga mbartja e humbjeve tatimore dhe e tatimit të zbritshëm të papërdorur.

7. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTET E TYRE

Mjetet monetare në arkë dhe në bankë më 31 dhjetor 2020 janë si vijon:

Shenime I

Mjetet monetare	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>	<u>Ndryshimi +/-</u>
Para në Banka	156,310,684.00	196,317,707.00	-40,007,023.00
Para në Arkë	33,584.00	72,893.00	-39,309.00
Totali	156,344,268.00	196,390,600.00	-40,046,332.00

Mjetet monetare në bankë përfshijnë llogaritë rrjedhëse në lekë dhe euro me të cilat Shoçeria kryen pagesat si dhe arkëton kërkesat nga të tretët. Shumat e shprehura në monedhë të huaj janë këmbyer në lekë duke përdorur kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Bankat	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>	<u>Ndryshimi +/-</u>
BKT "Shlv" Nr llog 110000976	155,479,322.00	186,585,609.00	-31,106,287.00
RAIFFEISEN "Tipografia" Nr llog 0100000115	826,571.00	9,727,307.00	-8,900,736.00
BKT "Tipografia" Nr llog 110000463	2,442.00	2,442.00	0.00

SIITYPHKRONJA E LETRAVE ME VLERE SIA.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK, përvçëse ku shprehet ndryshe)

UNION BANK "Tipografia" Nr llog 197428877030116	1,949.00	1,949.00	0.00
INTESA SAN PAOLO "Tipografia" Nr llog 20686130701	400.00	400.00	
Totali	156,310,684	196,317,707	-40,007,023.00

8. LLOGARI TË ARKËTUESHME DHE TË TJERA

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera më 31 dhjetor 2020 përbëhen si vijon:

<i>Shenime 2</i>	<i>31/12/2020</i>	<i>31/12/2019</i>	<i>Ndryshimi +/-</i>
(Shtypshkronja e Letrave me Vlere)	194,849,382.00	162,844,083.00	32,099,199.00
(Tipografi Ushtarakeper klientet QBZ Urdheri farnacise)	93,900.00	93,900.00	0.00
Tatim Fitimi	10,390,304.00	0	10,390,304.00
Kerkesa te tjera	5,125,791.00	104,457,222.00	-99,331,431.00
Totali	210,459,377.00	267,395,205.00	-56,935,828.00

Të drejta të arkëtueshme të tjera në total 4,512,057 lekë detajuar si më poshtë vijon "Shtypshkronja e letrave me vlere" Të drejta të arkëtueshme mbartur ndër vite 4,512,057 lekë :

1. **Shuma per 3,975,746 leke** - një detyrim i cili figuron ne bilanc prej vitit 2009 perfaqeson detyrimin qe ish drejtori Roland Sahaçia ka ndaj shoqerise ne shumen 3,938,475 leke (3879000+59475) dhe Altin Balla ne shumen 37,271 leke, sipas akti kontrollit te auditit te Ministrise se Financave Nr 5895/10 date 30.01.2008, shuma per 399,600 lekë konkretisht 373000 leke +26000 leke si me poshtë vijon:
2. **Shuma 373 000 leke** - Bazuar në Urdhërin e brendshem Nr 40 datë 04.02.2014 kryet njojja si debitore sipas raportit përfundimtare te Auditit Nr 16744/10 dt 14.01.2014 Rekomandimeve Nr 5,6,8 Në total vlera e detyrimit sipas raportit është 509400 lekë konkretisht Adem Rrenga 99000 lekë, Sokol Sheme 135800 lekë, Arben Doci 98200, Besnik Cobaj 98200 lekë dhe Albert Avdulaj 78200. Nga shuma e mësiperme është arritur të kryet vetëm ndalesa ndaj ish Administratorit Z Sokol Shenime në vlerën 138500 lekë mbajtur ne borderote e vitit 2014. Nga sa më lar Debitorë të tjerë sipas rap auditit 2014 është – 509400-135800 – 373600 lekë
3. **Shuma per 26.000 leke** - kryet njojja si debitore e Zj ADA GURI sipas raportit përfundimtare te KLSH Nr 1220/11 datë 20.06.2015 Pika B Masa për shpërbirim dëmi pika 2. "Shoqëria Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" të marrë masa për arkëtimin e shumës prej 78,000 lekë ndaj komisionit të blerjeve të vogla Ada Guri, Alkida Vladi, Ylli Veshi. Punonjesit Y.Veshi dhe A.Vladi kane shlyer detyrimin. Sa më lar, duhen vlerësuar të gjitha mundesitë ligjore për arkëtimin e tyre (si psh procese Gjyqësore etj), dhe ti paraqitet relacion Juridik Keshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë për Verdim Marje të mëtejshme.

SHTYP SHKRONJA E LETRAVE ME VLERE SHA.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK, përvetësuar ku shprehet ndryshe)

4. **Shuma prej 136,711 lekë - Bazuar ne Urdhërin e Brendshem Nr. 574 Prot. Date 27.11.2020 detyrim punonjësi ku detyrimi do bëhet me ndalesa periodike nga borderoja**

Të drejta të arkëtueshme mbartur nga Tipografia Ushtarake 81 876 lekë

Ku sipas detajimit në shenimet shpjeguese Pasqyra Financiare“ Tipografia Ushtarake”sha viti 2019 pasqyrojnë një detyrim prej 81876 lekë Kërkesë ndaj Xheni Krypi, në këtë shumë kanë paraqitur tërheqjet nga llogaritë bankare më tepër se detyrimi për pagat e Xheni Krypi (fq 16/18 të pasqyrave basikëlidhur Raportit të Audituesit Ligjor Nr 423 prot datë 14.09.2020).

Debitore të ndryshem (kalim fond shoqeri falimentim), 531,858 lekë përsaqëson:

Kalim fondi monetar për disa shoqëri në likuidim sipas Vendimit Nr 125 datë 12.12.2019 të Ministrit Financave che Ekonomisë në cilësine e Aksionerit të vetëm. Kaluar total 100,000,000 lekë Ky transefim likuiditeti është pasqyruar në llogarinë Debitorë të ndryshëm. Gjatë vitit 2020 sipas Vendimit Asamblesë së Përgjithshme Nr 90 27.07.2020 shuma prej 75,468,142 lekë është mbuluar nga destinimi i fitimit.

Gjithashu nga procesi i bashkimit është bërë eleminimi i vlerës 24,000,000 lekë e paraqitur në zërin “Kërkesa të Arkëtueshme” Nga Shtypshkronja e Letrave me vlerë sha dhe në zërin “detyrime afat shkurtra “tek shoqëria Tipografiz Ushtarake, si të drejta dhe detyrime ndaj njëra tjetrës pasi shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sha i ka kaluar fonde Tipografisë Ushtarake në mungesë Likuiditeti.

9. INVENTARI

Gjendja e inventarit sipas inventarizimit fizik të kryer më 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019, paraqitet si më poshtë:

Shenime 3	31/12/2020	31/12/2019	Ndryshimi +/-
Lende e pare	102,097,206	95,110,785	6,986,421.00
Prodhime në proces dhe gjysme produkte	28,730		28,730.00
Produkte te gatshme	483,747	430,436	53,311.00
			0.00
Totali	102,609,683.00	95,541,221.00	7,068,462.00

Në Inventari ‘Lënda e parë dhe materialeve të konsumueshme’ është në vlerën 102,097,206 lekë përkatësisht 101,902,740 lekë nga shtypshkronja letrave me vlerë shtuar 194,466 lekë nga inventari i mbartur nga Ish tipografia Ushtarake. Për Inventarët ‘Prodhime në proces dhe Gjysme produkte’ si dhe ‘Produkt i Gatshëm’ nuk ka patur shtesa të mbartura nga Tipografia Ushtarake.

SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERË SHA.

Shënimë shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Shumat janë të shprehura në LEK, përvçese ku shprehet ndryshe)

10. AKTIVET

Aktivet afatgjata materiale (AAM)

Shoqëria ka një vlerë neto aktivesh afatgjat material dhe jo materiale 103,092,194 leke nga te cilat 102,820,156 leke AAM dhe 272,038 leke AAJM. Nga kontrollet me zgjedhje të përdorura rezultoi se në aktiv të blanicit paraqiten të gjitha aktivet për të cilën shoqëria ka titull pronësie, se ato paraqiten të vlerësuara me vlerën e tyre të hyrjes në shoqëri, se ato ekzistojnë realisht, klasifikimi i tyre në element të veçantë është bërë në përpunhje me regullat e përcaktuara nga Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe ligji "Për Kontabilitetin". Për të gjitha ndryshimet në Aktive afatgjata materiale ekziston dokumentacioni përkatës:

Gjendja e caktiveve afatgjata materiale eshte paraqitur me vlerë neto me 31.12.2020, si me poshtë:

Shenime 4

Gjendja e Aktiveve Afatgjata me datë 31.12.2020

	Aktive lomtore/dale	Toka	Nderosha	Nderesat/Tipografie	Mise transport Makineni Pajisje	Makineri Pajisje/Tipografie	Pajisje/Tipografie	Inventar rikonomik "Tipografie"	Inventar i imet	Totali
Aktive të Tiposuzave										
Gjende 31.12.2019	570,440	8,857,600.00	65,253,949.00	19,034,430.00	7,382,390.00	189,913,134.00	409,860.00	9,030,829.00	-406,567.00	6,292,160.00
Shëness				0				93,000.00		1,668,150.00
Pakesim	298,402			25,610.00 (1,10)	7,331,754.00	5,424,265.00 (142,652.00)	273,320.00	7,062,516.00	337,372.00	3,382,430.00
Gjende 31.12.2019	272,038.00	8,857,600.00	39,653,934.00	44,706,676.00	1,350,125.00	47,207,502.00	136,500.00	2,069,313.00	69,295.00	4,577,780.00
Gjende ne 01.01.2020	272,038.00	8,857,600.00	39,653,934.00	11,702,675.00	1,268,125.00	47,287,502.00	36,540.00	2,069,313.00	69,295.00	4,577,780.00
Shësia ligjimit				0						-16,584,807.00
Pakesim		1,987,697.00	585,134.00	391,625.00	9,457,511		273,09	446,193	14,612.00	587,542
Gjende ne 31.12.2020	272,038.00	8,857,600.00	37,671,241.00	11,117,542.00	1,566,500.00	37,830,001.00	109,231.00	1,623,120.00	54,583.00	3,990,238.00
Vlera historike	570,440	8,857,600.00	65,263,919.00	19,034,430.00	7,382,390.00 (189,913,134.00)	409,860.00 (9,030,829.00)	109,231.00	1,623,120.00	54,583.00	103,092,194.00
Amortizimi Akumuluar -296,402.00	0.00	-27,592,033.00	-7,915,858.00	-5,615,890.00	-152,083,153.00	-300,629.00	-7,508,705.00	-351,384.00	-3,959,972.00	-205,838,375.00
Vlera në 01.12.2020	0.00	8,857,600.00	37,671,241.00	11,117,542.00	1,566,500.00	37,830,001.00	109,231.00	1,623,120	54,583	3,990,238

SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERE SHA.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK, përvçese ku shprehet ndryshe)

Aktive afatgjata jomateriale (AAJM)

Shoqëria ka aktive afatgjata jomateriale në shumën 272,038 LEK dhe amortizimi i tyre për vitin ushtimor 2020 është 0 LEK i cili ka rënduar shpenzimet sipas tabelës në shënimin nr.10 të Paqyrave Financiare.

Nr	Aktivet afatgjata jomateriale	Viti 2020	Viti 2019
1	Program finansiar	272,038.00	272,038.00
	Totali i AA jo materiale	272,038.00	272,038.00

11. DETYRIMET AFATSHKURTRA

Të pagueshme tregtare dhe të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2019 përbëhen si vijon

Shenime 5

	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>	<u>Ndryshimi +/-</u>
Tituj te huamarries	<u>57,541.00</u>	<u>9,611,735.00</u>	<u>-9,554,194.00</u>

Banka	Nr. Llogarise	<u>31/12/2020</u>
Credins Bank	00000661306	-28,741.33
Alpha Bank	AI83902112090201230023597229	
American Bank Of Investements	001335798	-20,800.00
American Bank Of Investements	002058379	-8,000.00
Totali		<u>(57,541.33)</u>

Gjatë vitit 2020 është bërë kthimi i huasë lënde e parë letër sipas kontratës së huamarries Nr. 706/3 datë 21.11.2019 detyrim i cili pasqyrohet ne pasqyrat financiare viti 2019 në vlerën 9,554,081 lekë si edhe titujt e huamarries se tipografisë 9,887 leke

12. TË PAGUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

Shenime 5

	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>	<u>Ndryshimi +/-</u>
Furnitore	11,567,288.00	19,009,726.00	7,442,438.00
Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqerore	2,111,667.00	6,043,464.00	(3,931,797.00)
Te pagueshme tatimore	10,732,340.00	14,643,307.00	(3,910,967.00)
Te tjera te pagueshme	7,556,003.00	29,496,046.00	(21,940,043.00)
Totali	<u>31,967,298.00</u>	<u>69,192,543.00</u>	<u>(37,225,245.00)</u>

Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit 11,567,288 lekë;

Ne këtë ze eshte perfshire gjendja e furnitoreve te palikuiduar me 31.12.2020, ku gjendja e palikuiduar nga aktiviteti i shtypshkronjës së letrave me vlerë është në shumen 8,239,280 leke, ndërsa gjendja e palikuiduar mbartur nga aktiviteti i Tipografisë Ushtarake është në vlerën 3,328,007 lekë

SHTYPSHIKRONJA E LETRAVE ME VLERE SHA.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK, përvçese ku shprehet ndryshe)

Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve Shoqërore/ shëndetsore

Në këtë zë është perfshire detyrimi ndaj punonjësve dhe sigurimeve me 31.12.2020 ne shumen totale 2,111,666 lekë, si me poshte:

Shenime 5 | 1

<u>Të pagueshme ndaj punonjësve</u>	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>	<u>Ndryshimi + -</u>
Paga dhe shperblime 'Shtypshkronja e Letrave me vlere'	0	0	
Sigurime shoq. dhe tap 'Shtypshkronja eletrave me vlerë'	1,904,854.00	1,748,234.00	156,630.00
Paga punonjësit 'Tipografia ushtarake'	150,080.00	209,729.00	-59,649.00
Sigurime shoq. dhe tap "Tipografia ushtarake"	56,722.00	4,085,450.00	4,028,728.00
Totali I detyrimeve ndaj punonjësve	<u>2,111,666.00</u>	<u>6,043,307.00</u>	<u>-3,931,541.0</u>

Tëk zëri pagat punonjësit Tipografia ushtarake paraqitet detyrimi për paga i mbartur në vlerën 150,080 sikurse është cilësuar dhe në shënimet shpjeguese PF nga Tipografia Ushtarake viti 2019 (fq 19) për punonjësin Jonada Cornani.

Shenime 5 | 2

Të pagueshme për detyrimet Tatimore

	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>	<u>Ndryshimi + -</u>
TVSH detyrim Shtypshkronja e Letrave me Vlere	10,693,669.00	6,165,819.00	4,527,850.00
Tatim Fitimi Shtypshkronja e letrave mevlore		4,357,877.00	- 4,357,877.00
Tatim ne burim Shtypshkronja eletrave mevlore	27,561.00	34,161.00	- 5,600.00
Të pagueshme për detyrimet tatimore Tipografia Ushtarake	11,110.00	4,085,450.00	- 4,074,340.00
Totali I detyrimeve tatimore	<u>10,732,340.00</u>	<u>14,643,307.00</u>	<u>- 3,910,967.00</u>

Shenime 5 | 3

	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>	<u>Ndryshimi - /</u>
Detyrime të tjera nga shly	44,285.00	88,353	- 44,068.00
Detyrime ndaj bashkisë "Tip Ushtarake"	2,025,747.00	1,676,414.00	349,333.00
Të pagueshme ndaj keshillit mbikëqyrës Tipografia Ushtarake	4,485,971.00	3,731,279.00	754,692.00
Detyrime Tipografia Ushtarake ndaj shoqërisë Regjistri Detar Shqiptar ne 2020 (ne 2019 ndaj Shly)	1,000,000.00	24,000,000	-23,000,000.00
Totali	<u>7,556,003.00</u>	<u>29,496,046</u>	<u>-21,940,043</u>

SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERE SHA.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK, përvçese ku shprehet ndryshe)

Detyrime te tjera nga shlv.

- vlera 44, 285 lekë detyrime të tjera nga aktiviteti i "Shtypshkronjës së Letrave me vlerë" vlerë që shoqëria jonë duhet të likuidojë ndaj shoqerive te tretë për llogari të punonjësve konkretisht:
 - 30,785 leke detyrim permbarimore i punonjeses V. Keçi si dhe,
 - kuotacion sindikata 13,500 ndalese nga paga dhjetor 2020.

Detyrimi ndaj shoqërisë "Regjistri Detar Shqiptar" paraqet detyrimin për financimin prej 1,000,000 lekë transferuar Tipografisë ushtarake sipas Vendimit të asambleës së Përgjithshme të Aksionarëve Nr. 103 datë 02.09.2020 për "Kalim Fondi" (Nr 16279 Protatë 02.09.2020) nga Regjistri Detar, financim për mbulim likuiditetesh për shlyerje detyrimesh. Kontabilizimi i transaksionit është pasqyruar në të njëjtën llogari kontabiliteti "detyrime të tjera" që Tipografia Ushtarake dhc raporti eksperit kontabël të audituesit ligjor kanë pasqyruar detyrimi i të njëjtës natyrë për transferim likuiditeti transferuar nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë Sha (Kalim fondi monetar për disa shoqëri në likuidim sipas Vendimit Nr. 125 datë 12.12.2019 të Ministrit Financave dhe Ekonomisë në cilësine e Aksionerit të vetëm.)

13. DETYRIMET AFATGJATA (HUAMARRJET DHE GRANTET)

Detyrimet afatgjata më 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 paraqiten sipas tabelës:

Shenime 6 |

	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>	<u>Ndryshimi +/-</u>
Grante	3,357,817.00	3,388,795.00	-30,978.00
Te Ardhura te shtyra	4,375,346.00	4,375,346.00	0.00
Totali	7,733,163.00	7,733,163.00	-30,978.00

Grantet rezultojne në këtë pozicion të pasqyrave financiare në shumën 3,357,817 LEK. Gjatë vitit 2020 shoqëria ka bërë rimarrje të granteve në shumën 30,978 LEK, të cilat i ka kontabilizuar në të ardhura (shih shënimin nr.10 të pasqyrave financiare). Në këtë pozicion rezulton edhe shuma 4,375,346 LEK e cila përfaqëson të ardhura të shtyra Kjo shume eshte k/partia e të tjera detyrime, shume kjo e cila ishte pasqyruar ne të ardhura te shtyra deri me 31.12.2017.

Sa më lart, pritet të ndiqen procedurat juridike nga institucioni për arketimin e shumës.

14. KAPITALET E VETA

Më 31 dhjetor 2020, kapitali aksionar ka vlerën 420,663,000 LEK që përbëhet nga 420,663 aksione me vlerë nominale 1000 LEK. Bazuar në ligjin shqiptar për shoqëritë tregtare, 5% e fitimit vjetor, duhet të kalojë çdo vit në rezervë ligjore, deri sa rezerva të arrijë vlerën 10% të kapitalit aksionar. Gjatë vitit 2020 nuk ka patur ndryshime në kapitalin themeltar ka pas rritje te rezerves ligjore me 4,507,175 leke .

SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERE SHA.

Shënimë shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK, përvçese ku shprehet ndryshe)

Në Raportin e Audituesit Ligjor Nr 423 prot dt 14.09.2020 "Për Bashkimin me Përthithje të "Tipografia Ushtarake" nga Shoqëria Shtypshkronja e Letrave me Vlerë Sha" Tiranë, në faqen 8 pasqyrohet bilanci i Bashkimit më datë 31.12.2019, në të cilin janë paraqitura të përthithura elementë të aktivit dhe pasivit të pasqyrave financiare. Gjithashtu audituesi ligjor ka pasqyruar dhe levizjet përsa i përket Kapitalit të Shoqërisë (sq 11)në zvogëlim të kapitalit nga 430,238,000 në 420,663,000 lekë (zvoglim i kapitalit nga bashkimi në vlerën 9,575,000 lekë)

Shenime 7

Kapitali dhe rezervat	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>	<u>Ndryshimi +</u>
kapitali I nenshkuar	420,663,000.00	420,663,000.00	0
Rezerva ligjore	26,965,024.00	22,457,849.00	4,507,175.00
Rezerva Statutore per investime	57,829,852.00	54,224,112.00	3,605,740.00
Fitime e humbje e vitit ushtimor	27,289,645.00	90,143,504.00	-62,853,859.00
Totali I kapitalit	532,747,521.00	587,488,465.00	-54,740,944.00

15. TË ARDHURA NGA SHITJA

Njohja dhe vlerësimi i të ardhurave është bërë në bazë të SKK8 të përmirësuar, të Ardhurat janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar duke marrë parasysh zbritjet e ofruara nëse ka. Të ardhurat nga shitja për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 përbëhen si vijon:

Shenime 8

	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>	<u>Ndryshimi +</u>
Të ardhura nga aktiviteti kryesor "shtypshkronja e Letrave me Vlere"	226,971,711.00	345,645,793.00	118,674,082.00
Të ardhura nga aktiviteti kryesor "Tipografia Ushtarake"	1,160,700.00	1,210,200.00	-49,500.00
Totali I	228,132,411.00	346,855,993.00	118,723,582.00

Ndryshimi i gjendjes se produktit

Ne kete post paraqitet ndryshimi i gjendjes se produkteve te gatshme me 31.12.2020 në shumën **82,041** leke.

Shenime 9

	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>	<u>Ndryshimi +</u>
Ndryshimi i gjendjes se produktit:	<u>82,041.00</u>	<u>-335,896.00</u>	<u>-253,855.00</u>

Te ardhura te tjera

Ne kete post paraqiten te ardhura te tjera ne shumen 32 561 leke, te detajuara si me poshtë:

<i>Shenime 10</i>	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>	<u>Ndryshimi +</u>
Rimarrje grantesh	30,978.00	138,554.00	-107,576.00
Te ardhura te tjera (penalite levrim vonuar, inkles punonjesit etj)	1,583.00	250,484.00	-248,901.00
Totali i te ardhurave	32,561.00	389,038.00	-356,477.00

SHTYPSHIKRONJA E LETRAVE ME VLERE SHA.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK, përvçese ku shprehet ndryshe)

16. KOSTO E LENDES SË PARE

Slipenzimet për lëndë të parë dhe materiale të konsumueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si vijon:

Shenime 11

	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>	<u>Ndryshimi + -</u>
Lerde e pare dhe materiale te konsumueshme "Shlv"	98,153,264.00	144,246,829.00	-46,093,565.00
Lende e parë dhe materiale te konsumueshme "Tipografia"	0	2,179,294.00	-2,179,294.00
Shuma	98,153,264.00	146,426,123.00	-48,272,859.00

17. KOSTOT E PERSONELIT

Kostot e personelit përbëhen nga pagat dhe slipenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore:

Shenime 12

Kosto e Punës	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>	<u>Ndryshimi + -</u>
Shpenzime per paga "shtypshkronja e Letrave me vlerë"	61,130,954.00	61,593,111.00	-462,157.00
Shperzime per paga "Tipografia Ushtarake"	2,754,982.00	1,392,000.00	1,362,982.00
Sigurimeshoqeroredhe shendetesore "Shlv"	9,807,003.00	9,816,794.00	-9,791.00
Sigurime shoqerore dhc shendetesore	311,789.00	232,464.00	79,325.00
Shuma	74,004,728.00	73,034,369.00	970,359.00

18. SHPENZIME TE KONSUMIT DHE AMORTIZIMIT

Shenime 13

Amortizimi	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>
Amortizimi i aseteve "Shlv"	12,865,558.00	15,575,844.00
Amortizimi i aseteve "Tipografia Ushtarake"	627,055.00	681,144.00
Shuma	13,492,613.00	16,256,988.00

19. SHPENZIME TE TJERA

Slipenzime të tjera pasqyrojnë slipenzime për shërbime ndihmëse nga të tretë që lidhen drejtpërdrejtë me veprimtarinë e shfrytëzimit si dhe për qëllime administrative.

Slipenzimet e tjera më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2019 ne Total **10,405,805** leke.

SHTYPHKRONJA E LETRAVE ME VLERE SIIA.

Shënimë shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK, përvetësë ku shprehet ndryshe)

Shënime I4

I.Shpenzime te tjera “Tipografia Ushtarake

Taksa vendore	<u>31/12/2020</u>
Sherbime bankare, komisione	349,333.00
Gjøba penalitete (37 939 lekë) permbarues (407691 lekë)	9,887.00
Ekspert kontabel	445,630.00
Kancelari	825,200.00
Energi elektrike	1,450.00
Totali	23,933.00
	<u>1,665,433.00</u>

II.Shpenzime te tjera “Shtypshkronja e Letrave me Vlere”

	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>
Sherbim postar dhe tel	95,855.00	110,094.00
Taksa automjeti	146,132.00	161,686.00
Taksa vendore	376,680.00	351,180.00
Demshperblime per paga, permbarim,kamata etj	36,821.00	558,498.00
Sherbime bankare, komisione	26,845.00	37,955.00
Derdhje ne Buxhetin e shtetit per Covidin ndalese nga pagat e këshillit	506,220.00	-
Sherbiri internet(host domain ëeb)	29,700.00	-
Sherbim roje private	3,389,402.00	2,376,042.00
Energi + uje	2,207,750.00	2,304,514.00
Siguracion ndertese	399,498.00	399,300.00
Mirembajte e riparime	208,512.00	146,000.00
Ekskursion turistik	-	795,000.00
Riparim testim kolaudim fikse zjarri	95,000.00	-
Fv kamera sigurie	96,000.00	-
Punime hidraulike	24,079.00	86,290.00
Ekspert auditimi pasqyra finansiar	320,000.00	255,000.00
Ekspert procedura e Bashkimit me Tipografine Ushtarake	450,000.00	-
Analiza e formatit te certificates, Inspektorati Shteteror teknik	18,000.00	18,000.00
Ndertim faqe internet	-	70,000.00
Blerje biloqe tvsh Aplikime QKR (Arke Banke)	4,200.00	2,280.00
Perkthime	3,000.00	-
Sherbim printer (bërë npm magazines lendet ndihmese)	-	445,000.00
Konsum karburart (sipas daletjeve ne magazinene lendet ndihmese)	306,678.00	199,778.00
Totali	8,740,372.00	<u>8,316,617.00</u>
Totali I+II	10,405,805.00	

SIITVPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERE SHA.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK, përvetësuar nga shprehjet ndryshe)

20. TE ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE

Të ardhura dhe shpenzime financiare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si vijon:

Te ardhura nga kursi i kembimit o (Zero)

21. TATIM FITIMI

Shenime 15

Shoqëria është subjekt i tatim fitimit në Shqipëri, norma e tatim fitimit për vitin 2020 është 15%. Ligjet dhe irregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Shoqëria zbaton tatim fitimi të shtyrë. Në llogaritjen e tatim fitimit shoqëria ka zbatuar SKK 11 të përmirësuar dhe ka zbatuar kërkesat e legjislacionit fiskal në fuqi.

Llogaritja e normës së tatim fitimit efektiv për vitin 2019 dhe 2020 është paraqitur në vijim:

Shenime 16

	31/12/2020	%	31/12/2019
Te ardhura	228,247,013.00	15	346,034,831.00
Shpenzime	(196,056,410.00)	15	(239,885,091.00)
Rezultati i ushtrimit	<u>32,190,603.00</u>	<u>15</u>	<u>106,149,740.00</u>
Shpenzime te pazbritshme	<u>482,451.00</u>		<u>558,498.00</u>
<i>Gjoba, kamata, demshperblime</i>	<u>482,451.00</u>		<u>558,498.00</u>
Rezultati tatimore	<u>32,676,054.00</u>		<u>106,708,238.00</u>
Tatim fitimi	4,900,958.00	15	16,006,236.00
Fitimi / humbja neto	27,289,645.00		90,143,504.00

22. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA

Në kontabilizimet e bankes Raiffeisen të Tipografisë Ushtarake, "Pagesa viti 2020" është bërë pasqyrimi saktë i kontabilizimit në lidhje me detyrimet tatimore duke debituar sipas fdp detyrim tatimore, dhe si shpenzimi i panjohur i gjobave, kamatave dhe interesave. Por duke qënë se në pasqyrat financiare të "Tipografisë ushtarake" viti 2019, si detyrime tatimore kanë pasqyruar në total vlerën e detyrit + gjobat kamavonesat dhe interesat, kjo e bën të detyrueshme që gjobat, kamavonesat, interesat e paguara gjatë vitit 2020 të registrohen si shlyerje detyrimi dhe jo si shpenzim konkretisht gjobat, kamavonesat, interesat në vlerë totale 2,924,340 lekë, kanë kaluar 272,680 për shlyerje detyrim paraqitur për sigurime shoqërore Shëndetsore, 2,613,721 lekë për shlyerje detyrim tatimore dhe diferenca 37,939 është pasqyruar si gjobe.

SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERE SHA.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK, përvetësose ku shprehet ndryshe)

23. PALET E LIDHURA

Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse është caktuar një çmim. Njësitë konsiderohen si të lidhura, nëse njëra palë ose kontrollon palën tjetër, ose ka një influencë të ndjeshtme mbi palën tjetër, ose kur kanë kontroll të përbashkët të një njësie tjetër ose kur është anëtar i personelit drejtues të njësisë apo të shoqërisë mëmë të saj (duke përfshirë familjarë të afërt të ndonjërit prej individëve të referuar më sipër). Kontrolli është pushteti për të drejtuar politikat financiare dhe operacionale të një shoqërie në mënyrë që të marrësh përfshire nga aktiviteti i saj. Kontrolli ekziston kur mëma, direkt ose indirekt, zoteron më shumë se gjysmën e të drejtave të votave, të shoqërisë bijë.

24. NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme të cilat kërkojnë rishikime ose ndryshime në këto pasqyra financiare. Në fund të vitit 2020 dolën për herë të parë lajmët nga Kina në lidhje me COVID-19 (Coronavirus). Situata në fund të vitit ishte se një numër i kufizuar i rasteve të një virusi të panjohur ishin raportuar në Organizatën Botërore të Shëndetit. Në muajt e parë të vitit 2020 virusi ishte përhapur globalisht dhe ndikimi i tij negativ ka fituar një impuls. Manaxhimi e konsideron që informacion të jetë një ngjarje jo rregulluese pas datës së raportimit. Ndërsa kjo është ende një situatë në zhvillim në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare, deri më tanë ka pasur ndikim në operimet e Kompanisë, duke reduktuar shtypshkrimet e pozitura nga institucionet e ndryshme ku përmëndim një reduktimnë porositë për biletat e transportit të udhëtarëve e.tj.

Manaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të githë hapat e mundshëm për të zbutur çdo efekt.

Miratoi

Administratori



Hartoi

Kryetare e Deges se Finances

Besjana DERVISHI

A handwritten signature in black ink, appearing to read "BD".